



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6537 Prot.

Roskovec, më 01, 10 2021

**V E N D I M**

Nr. 77, datë 30/09 /2021

**“PËR MIRATIM TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN  
2021”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2 gërma b, neni 23 dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore”, neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44, paragrafi II, gërma a, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB nr.89 datë 02.12.2020 “Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjeve vartëse si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2021”, Këshilli i Bashkisë;

**V E N D O S I :**

I. Të miratohet transferimi i fondeve buxhetore ndërmjet programeve për nevojat shtesë për shpenzime për energji elektrike në shumën 3,200,000 lekë si dhe për organizimin e festave “Të Ullirit” dhe “Të Fundvitit” (diferenca nga shuma e fondit të kërkuar) 960,000 lekë, si më poshtë vijon:

**Shtohet:**

**1. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001**

NR	GR	PROG RAMI	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe shtohet	2021	2022
1	00	04240	5	602	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	Shpenzime operative & te mirembajtjes	3,200,000	3,200,000	
2	00	01110	5	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Shpenzime operative & te mirembajtjes	960,000	960,000	
						<b>SHUMA:</b>	<b>4,160,000</b>	<b>4,160,000</b>	



**Pakësohet:**

**1. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001**

NR	GR	PROG RAMI	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Planifikimi vjetor 2021	Shpenzuar per periudhen 9-mujore 2021	Fondi i planifikuar i ngelur	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2021	2022
1.	00	03140	5	600	Shërbimet e Policisë Vendore	Shpenzime per paga	3,589,239	1,638,064	1,951,175	900,000	900,000	
	00	03140	5	601	Shërbimet e Policisë Vendore	Shpenzime per kontribute	584,373	242,920	341,453	100,000	100,000	
2.	00	06140	5	600	Planifikimi Urban Vendor	Shpenzime per paga	3,953,861	1,792,181	2,161,680	700,000	700,000	
	00	06140	5	601	Planifikimi Urban Vendor	Shpenzime per kontribute	641,925	305,990	335,935	100,000	100,000	
3.	00	08230	5	600	Arti dhe kultura	Shpenzime per paga	2,159,724	307,027	1,852,697	1,200,000	1,200,000	
	00	08230	5	601	Arti dhe kultura	Shpenzime per kontribute	352,324	64,514	287,810	200,000	200,000	
						<b>SHUMA:</b>	<b>11,281,446</b>	<b>4,350,696</b>	<b>6,930,750</b>	<b>3,200,000</b>	<b>3,200,000</b>	

**2. NJESIA SHPENZUESE "NDERMARJA E SHERBIMEVE TE MIREMBAJTJES", KODI 2113002**

NR	GR	PROG RAMI	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Planifikimi vjetor 2021	Shpenzuar per periudhen 9-mujore 2021	Fondi i planifikuar i ngelur	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2021	2022
1.	00	06440	5	602	Ndricimi i rrugeve dhe dekori	Shpenzime operative & te mirembajtjes	960,000	0	960,000	960,000	960,000	
						<b>SHUMA:</b>	<b>960,000</b>	<b>0</b>	<b>960,000</b>	<b>960,000</b>	<b>960,000</b>	

**II.** Ngarkohet Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**  
**Kadri Hyska**

